



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS**

OPINION MBI KANDIDATIN Z. ERJON SHQARRI

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 05.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

- *Këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (6 vende);*

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë paraqitur kërkesë 12 (dymbëdhjetë) prokurorë.

Në datë 19.02.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurorit Erjon Shqarri, i cili është caktuar si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar cënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

- Prokurori Erjon Shqarri ushtron funksionin e magjistratit që prej vitit 2015, pasi me dekretin nr. 9298, datë 02.11.2015 të Presidentit të Republikës, është emëruar prokuror në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë. Më përpara ka ushtruar funksionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore. Nga dosja personale rezulton se ka patur disa transferime dhe caktime të përkohëshme, fillimisht si prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me Urdhërin Nr. 276 datë 07.12.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm është caktuar përkohësisht si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin Nr. 184, datë 27.09.2019 të KLP-së është ndërprerë caktimi i përkohëshëm si prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë dhe është vendosur kthimi në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Z. Erion Shqarri ka një eksperiencë profesionale në punë si prokuror rreth 5 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë ku është i caktuar, rezulton se:

- Nga kthim-përgjigja nr.1959 datë 21.02.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë rezulton se për shkak ngarkese në këtë Prokurori, vetëm një prej tre kandidaturave të ardhura nga kjo Prokurori, nuk dëmton interesat aktuale të Prokurorisë së Vlorës, por pa specifikuar një emër konkret.

Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se, në kushtet kur janë tre kandidatura nga e njëjta prokurori dhe nga ana e Drejtuesit nuk është përcaktuar një emër konkret, në raportin mes kandidaturave, njëri kandidat ka eksperiencë të mëparshme si Këshilltar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe nuk ka dosje penale në administrim në Prokurorinë e Vlorës. Për këtë arsye Komisioni mendon se komandimi i Z. Shqarri do të cënonte mbarëvajtjen e punës dhe interesin më të lartë të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Përfundimisht nga kandidimi për komandim të prokurorit Erjon Shqarri, për shkak se komandimi i tij do të ndikonte veprimtarinë normale të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Datë: 24.02.2020